



Mbi politikat për Reformën zgjedhore, 2025

**Mbështetur në analizën e zgjedhjeve parlamentare,
11 Maj 2025
Njësia zgjedhore Qarku Durrës**

**Mbi politikat
për
Reformën zgjedhore, 2025**

**Mbështetur në analizën e zgjedhjeve parlamentare,
11 Maj 2025
Njësia zgjedhore Qarku Durrës**

**Hartoi
Prof. Dr. Kristaq Kume**



Nuk lejohet shpërndarja në mënyrë jo të autorizuar e këtij Raporti.

Përmbajtje

Përmbledhje	4
Hyrje	6
1 Konteksti	7
2 Çështje që rekomandohen të trajtohen në Reformë zgjedhore	8
3 Mbi kompleksitetin e Reformes zgjedhore	10
4 Nevoja për hartimin e dokumentit mbi “Politikat për zhvillimin e Reformës zgjedhore”	11
5 Mbi dokumentin e Politikave për Reformën zgjedhore	11
5.1 Vizioni, parimet dhe objektivat e politikave për Reformën zgjedhore	12
5.1.1 Vizioni i Reformes zgjedhore	13
5.1.2 Parimet udhëheqëse të Reformës zgjedhore	13
5.1.3 Objektivat strategjikë	14
5.2 Çështje dhe probleme, objekte trajtimi në Reformën Zgjedhore	14
5.2.1 Sistemi zgjedhor	14
5.2.2 Depolitizimi i administratës zgjedhore	15
5.2.3 Financimi i fushatave zgjedhore dhe transparenca	16
5.2.4 Shitblerja e votës dhe përdorimi i burimeve shtetërore	17
5.2.5 Votim i fshehtë dhe parandalimi i intimidimit te zgjedhesve	18
5.2.6 Regjistrimi i votuesve dhe votimi nga jashte territorit te vendit	18
5.2.7 Media në fushatën zgjedhore	19
5.2.8 Ankimet zgjedhore, administrimi dhe gjykimi	19
5.3 Përdorimi i teknologjise ne zgjedhje dhe transparenca	20
5.4 Zhvillimi dhe monitorimi i reformës zgjedhore	20
5.5 Hartimi i Planit të Veprimit per Reformen zgjedhore	21
5.6 Burime dhe materiale për konsultim dhe referencë	21
Aneks I Tabelë krahasuese e rekomandimeve të OSBE/ODIHR	22
Aneks II Rekomandime të mundshme nga OSBE/ODIHR (paraprakisht)	23
Aneks III Çështje qe rekomandohet per trajtim ne Reformen zgjedhore	24
Raporti i CSDS. Zgjedhjet parlamentare, 11 Maj 2025 -Qarku Durrës	

Pëmbledhje ekzekutive

Reforma zgjedhore është një ndër proceset legjislative në të një rendesise të vecante, që trajton çështje themelore për funksionimin e demokracisë, shtetit të së drejtës dhe funksionimit të institucioneve përfaqësuese. Në çdo shoqëri demokratike, zgjedhjet janë instrumenti themelor për përcaktimin e vullnetit të qytetarëve dhe legjitimitetin e pushtetit politik. Në Shqipëri, pas tri dekadash pluralizëm politik, proceset zgjedhore kanë bërë përparime të rëndësishme teknike dhe administrative, por kanë mbetur ende të shoqëruara nga mosbesim publik, tension politik dhe kontestime për integritetin e procesit. Në këtë kontekst, reforma zgjedhore nuk është vetëm një domosdoshmëri teknike, por një detyrë politike, shoqërore dhe demokratike për të konsoliduar besimin e qytetarëve tek vota dhe institucioni i zgjedhjeve.

Ndër arsytet themelore që aktualisht kushtezojnë kryerjen e reformes zgjedhore mund të rendit si ndër më kryesoret:

a) Rritja e besueshmërisë publike në proceset zgjedhore

Një ndër sfidat më të mëdha që kanë shoqëruar zgjedhjet në Shqipëri është mungesa e besimit të plotë tek administrimi dhe rezultati përfundimtar. Pavarësisht përmirësimeve teknologjike dhe procedurale, perceptimi për ndikim politik mbi administratën zgjedhore mbetet i lartë. Reforma duhet të synojë depolitizimin e plotë të administratës zgjedhore dhe ngritjen e një strukture profesionale, neutrale dhe të qëndrueshme në kohë.

b) Adresimi i rekomandimeve të OSBE/ODIHR dhe partnerëve ndërkombëtarë

Raportet përfundimtare të OSBE/ODIHR pas zgjedhjeve të viteve 2021, 2023 dhe 2025, kanë përsëritur nevojën për:

- (i) ndarje më të qartë të kompetencave ndërmjet institucioneve zgjedhore;
- (ii) transparencë më të lartë në financimin e fushatave;
- (iii) zbatim efektiv të ndalimeve për përdorimin e burimeve publike në fushatë;
- (iv) përmirësim të mekanizmave të ankimit dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore.

Zbatimi i këtyre rekomandimeve përbën një detyrim ndërkombëtar në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe një standard demokratik që duhet përmbushur.

c) Sigurimi i konkurrencës së ndershme dhe barazisë në garën politike

Zgjedhjet e lira nuk nënkuptojnë vetëm aktin formal të votimit, por edhe garën e ndershme ndërmjet subjekteve politike. Praktika e deritanishme ka treguar se përdorimi i burimeve shtetërore, kontrolli mbi administratën publike apo fushatat e parakohshme deformatojnë parimin e barazisë. Reforma duhet të forcojë sanksionet ligjore, monitorimin e fushatave dhe transparencën e financimeve politike për të krijuar kushte reale konkurrence.

d) Përmirësimi i listave të votuesve brenda e jashtë vendit dhe votimit nga jashtë vendit

Saktësia e listave, verifikimin elektronik i votuesve, si dhe krijimi i mundësive reale për votën nga jashtë territorit të vendit bëjnë pjesë në punën që kushtezojnë ndjeshme realizimin e zgjedhjeve në përputhje me parimet e trashëgimise zgjedhore Europiane, anagazhimeve të OSBE për zgjedhje dhe Kodit të Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venencies.

e) Zhvillimet politike dhe shoqërore aktuale

Polarizimi i thellë politik dhe krizat e përsëritura institucionale e bëjnë të domosdoshme një reformë që të bazohet në konsensus kombëtar.

Aktualisht reforma zgjedhore është jo vetëm një proces teknik, por edhe një instrument për rivendosjen e dialogut politik, stabilitetit institucional dhe funksionimit normal të demokracisë parlamentare.

Reforma zgjedhore i duhet shtetit, qytetarve dhe shoqërisë sepse efektet e saj ndikojnë direkt në: (i) forcimin e shtetit të së drejtës, (ii) procesin e integritetit evropian, (iii) përfaqësimin me cilësi dhe të drejtë të qytetarve dhe (iv) funksionimin me efektiv të demokracisë përfaqësuese.

Hartimi i një Politike Kombëtare në të cilën të trajtohen çështjet, problemet, rruget dhe instrumentat që duhet të përdoren për të realizuar një Reformë zgjedhore të sukseshme është një moment i rëndësishëm që kushtëzon arritjen e pritshmërive që duhet të plotësojë kjo reformë. Trajtimi në dokumentin e kësaj Politike i prioritetëve që duhet të synojë të realizojë reforma zgjedhore, përcaktimi dhe argumentimi i domosdoshmërisë për kryerjen e një reforme konsensuale dhe gjithëpërfshirëse në pjesëmarrje dhe problematike, theksimi i nevojës për asistencë dhe keshillim nga institucionet ndërkombëtare si Zyra e ODIHR dhe Komisioni i Venecias janë ndër momentet më të rëndësishme të përfshira në dokumentin e kësaj Politike.

Në këtë dokument theksohet se Reforma zgjedhore duhet të konsiderohet dhe të zhvillohet si një proces i cili do të shërbejë për të hedhur themelet e një epokë të re të stabilitetit politik, pjesëmarrjes qytetare dhe integritetit evropian të vendit.

Hyrje

Në vendet dhe shoqëritëe demokratike proceset per zgjedhjen e organeve perfaqesues ne nivel qendror dhe lokal jane rruga nepermjet te ciles populli arrin te ushtroje te drejten e sovranit. Vota si instrumenti i vetem dhe i gjithëfuqishem ne shoqerite demokratike është gur i themelit mbi te cilin ndertohen te gjithë institucionet e tjera, nepermjet te cilëve behet e mundur zbatimi i kontrates sociale, dokumenti baze i te ciles është Kushtetuta e vendit. Krijimi, respektimi dhe zbatimi i kushteve dhe rregullave sipas te cilave duhet te perdoret vota per te ndertuar nepermjet saj institucione dhe organet perfaqesuese është nje nder detyrat, pergjegjesite dhe objektivat kryesor qe duhet te kete çdo shoqeri demokratike. Nder keto rregulla, kryesor është Kodi zgjedhor. Bashke me te dhe krahas tij është edhe e gjithë ngrehina tjeter legjislative qe rregullon funksionimin e institucione qe tjerat si jane partite politike dhe institucionet ligjzbatuese, te cilet me punen dhe veprimtarine e tyre ndikojne ne zhvillimin e sukseshem te proceseve zgjedhore.

Hartimi i kuadrit legjislativ qe rregullon organizimin dhe zhvillimin e proceseve zgjedhore është nje proces kompleks dhe i vazhdueshem ne kohe. Ky proces është i domosdoshme te zhvillohet si nje proces gjithëperfshires ne problematiken qe duhet te trajtoje dhe te zgjidhet. Ai duhet te zhvillohet si proces qe arrin te sjell produkte tek te cilet materializohen kontributet e te gjithë aktoreve politik, institucional dhe shoqeror.

Procesi i rregullimit te kuadrit legjislativ qe trajton çështje te proceseve zgjedhore ne Shqiperi, kryhet si detyre dhe pergjegjesi e Kuvendit te Shqiperise, i cili, per kete qellim, aktivizon nje strukture te posaçme, Komisionin *ad-hoc* per Reformen zgjedhore. Ne gjetjen dhe percaktimin e zgjidhjeve per nderhyrjet dhe ndryshimet qe duhet te behen ne legjislacionin zgjedhor, ky Komision, si theksohet ne Kodin e Praktikave te Mira per Çështjet Zgjedhore, te Komisionit te Venecies, duhet te kete si udherrefyes dhe objektiv kryesor ne pune e tij, realizimin e nje produkti ligjor zbatimi i te cilit te sherbeje per rritjen e besimit te publikut ne zgjedhje dhe rritjen e legjitimitetit te institucioneve qe dalin nga proceset zgjedhore. Hartimi i nje legjislacioni, pjese e te cilit duhet te jete jo vetem Kodi Zgjedhor, është e domosdoshme te kryhet duke synuar perhere krijimin e nje terreni ligjor qe duhet te mbështet zhvillimin e zgjedhjeve ne perputhje me standardet e gjithë pranuar nderkombetare.

Praktikat e derisotme ne proceset legjislative qe kane objekt te tyre Reformen zgjedhore tregojne se, ne pjesen kryesore te tyre puna ne kuader te kesaj reforme është kryer dhe ka dhene produket si nje proces bipartizan. Gjithëperfshirja ne kete proces, e kerkuar ne menyre te vazhdueshme edhe prej OSBE/ODIHR dhe prej shoqerise civile shqiptare është perdorur vetem si fasade. Rezutatet e marra nga reformat e kryera , ne te shumten e tyre kane qene zgjidhje qe kane favorizuar hartuesit e tyre, dy partite kryesore politike te vendit, PS dhe PD. Interesi i ketyre dy forcave kryesore politike jo vetem qe ka qene dominues ne punen e Komisionit per Reformen zgjedhore por, ne jo pak raste vullneti i ketyre dy partive politike ka bere qe, ne menyre te perseritur te shkohet ne zgjedhje per Kuvendin ose per organet te vetëqeverisjes vendore, pa i paraprire me rregullimet e kerkuara ne legjislacion dhe te rekomanduara nga Misionet e Vezhguesve Nderkombetar te OSBE/ODIHR dhe nga OJF vendase qe kane monituruar dhe vëzhguar zgjedhjet.

Nevojat për të mirë rregulluar legjislacionin zgjedhor, Kodin zgjedhor dhe të tjere ligje zbatimi i të cileve ndikon në ecurine dhe zhvillimin në përputhje me kërkesat e standardeve për zgjedhje demokratike, si janë ligji për partitë politike dhe për financimin e tyre ose Kodi Penal i Republikës etj., kërkojnë që qasja ndaj këtij procesi legjislativ kompleks të ndryshojë nga qasja sipas të ciles është kryer deri sot.

Në këtë dokument behen përpjekje për të treguar dhe propozuar se çfarë duhet të mbahet parasysh, cilat mund ose duhet të jenë çështjet objekt të reformës zgjedhore të rradhes, në cilin format, me çfarë pjesëmarrje dhe në çfarë shtrirje në kohë, duhet të zhvillohet Reforma zgjedhore. Dokumenti synon të sjell mendime dhe ide në trajtën e një dokumenti për politikën që duhet të ndiqen, për të bërë të mundur zhvillimin e një Reforme zgjedhore të sukseshme.

1. Konteksti

Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, që u zhvilluan më 11 Maj 2025 nuk u paraprinë nga një Reforma zgjedhore, nëpërmjet të ciles të beheshin rregullit në Kodin zgjedhor për të pasqyruar rekomandimet e misioneve të vezhguesve ndërkombëtarë të OSB/ODIHR dhe rekomandimet ose propozimet e bera nga shoqëria civile shqiptare. Kodi zgjedhor u ndryshua vetëm për të pasqyruar në të vendimet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me votimin nga jashtë territorit të vendit dhe për votimin me votë parapëlqyese ose për votim me liste të hapur. Ndryshimet u bënë vetëm mbi bazën e dakortësive bipartizane, PS & PD.

Ndryshimet e fundit që janë bërë në Kodin zgjedhor, të cilat preken një numër të konsiderueshëm çështjesh, ku përfshihen çështje që lidhen me administratën zgjedhore si është kompozimi i KQZ duke e ndertuar atë si një institucion me strukturë të përzier, Komisioneri shtetror, Komisioni Rregullator dhe Komisioni për Ankimet dhe Sanksionet, rregullime që lidhen me përdorimin e aseteve publike, median, ankimet dhe sanksionet për shkeljet zgjedhore, etj... Ndryshimet e bera në legjislacionin zgjedhor, në korrik, 2021 dhe zbatimin e tyre në zgjedhjet parlamentare 2021 dhe zgjedhjet vendore, 2023, treguan ishte ecur në rrugën e duhur, por në të njëjtën kohë u tregua se këto ndryshime nuk mjaftojnë. Efektet e tyre ishin larg pritshmërisë dhe, për pasojë edhe nevoja për t'i rikonsideruar u evidentua qartë¹

Monitorimi dhe vëzhgimi i zgjedhjeve parlamentare që u zhvilluan më 11 maj 2025, në jo pak raste tregoi se, mungesa e Reformës zgjedhore krijoi hapsira për përballjen e procesit zgjedhor me fenomene negative, të njëjta me ato të ndeshura në zgjedhjet paraardhëse. Shit-blerja e votes, përdorimi i aseteve publike në funksion të fushës zgjedhore, presioni dhe intimidimi i zgjedhësve, prezenca e shtuar e personave të paautorizuar në qendrat e votimit, votimi familjar etj...ishin fenomene që u vëzhguan në këto zgjedhje. Këto e raportuan edhe vezhguesit që aktivizoi Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, për monitorimin dhe vëzhgimin e zgjedhjeve në njësinë zgjedhore, Qarku Durrës²

¹ Republika e Shqipërisë, Zgjedhjet Parlamentare, 25 prill 2021: Raporti Përfundimtar. <https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>

Republika e Shqipërisë, Zgjedhjet Vendore, 14 maj 2023: Raporti Përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve. <https://www.osce.org/files/f/documents/0/a/557277.pdf>

² CSDC (2025) Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, 11 Maj 2025, Raport përfundimtar – Qarku Durrës

2. Çështje që rekomandohen të trajtohen në Reformë zgjedhore

Duke patur si objektiv kryesor rregullimet që duhet të behen në legjislationin zgjedhor për të krijuar kushte mbështetese sa më të mira dhe sa më shumë efektive për zhvillimin e zgjedhjeve, si procese më të rëndësishme në një demokraci funksionale, Reforma zgjedhore duhet të kryhet duke u mbështetur në përvorjen që krijohet nga zgjedhjet, rekomandimet që japin vezhguesit ndërkombëtar dhe vendas, rekomandimet dhe opinionet që shpreh Komisioni i Venecias dhe institucionet e tjera ndërkombëtare. Është e rëndësishme që i gjithë ky proces legjislativ të mbështetet në analiza sa më të plotë e të thellë, objekt i të cilave duhet të jenë problemet dhe situatat politike, ekonomike dhe sociale të vendit, kultura dhe përvorjat e fituara në sjelljen ndaj legjislationit në përgjithësi dhe atij zgjedhor në veçanti në proceset e mëparshme zgjedhore.

Puna për kryerjen e çdo reforme zgjedhore fillon me përcaktimin dhe listimin e çështjeve që do të jenë objekt i saj si dhe hartimin e metodologjisë dhe rregullores së punës për Komisionin parlamentar ad-hoc. Nderkohe duhet të theksohet se, shumë e rëndësishme për suksesin e reformës është edhe konceptimi dhe zhvillimi i saj si një proces gjithëpërfshirës.

Hartimi i një dokumenti udhëzues, në trajtën e një dokumenti politik për reformën zgjedhore është një mundësi e mirë dhe e rekomandueshme që shërben për të rritur mundësitë e suksesit në këto reforme.

Miratimi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë më 28 Nëntor 1998, hap rrugën për zhvillimin e procesit legjislativ, objekt i të cilit është Kodi zgjedhor. Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të vitit 2001 janë të parat zgjedhje që u zhvilluan duke zbatuar kërkesat dhe përcaktimet ligjore të shprehura në një Kod zgjedhor. Pas kësaj, të gjitha zgjedhjet pasardhëse, si rregull janë paraprirë nga procese legjislative reformuese të Kodit zgjedhor. Reformat zgjedhore Kuvendi i Shqipërisë i ka kryer përherë nëpërmjet përgatitjes së ndryshimeve në Kodin zgjedhor nga një komision parlamentar *ad-hoc*, puna e të cilit, në të gjitha rastet ka qenë produkt i konsensusit bipartizan.

Ndër materialet kryesore që ka përdorur trupa legjislative në punën për Reformën zgjedhore, veçohen rekomandimet që kanë dhënë misionet e vezhguesve ndërkombëtar të OSBE/ODIHR që kanë vezhguar zgjedhjet parlamentare. Edhe aktualisht, nga drejtues kryesor të mazhorancës qeverisëse është deklaruar se reforma zgjedhore, që pritet të fillojë, do të ketë në qendër të vëmendjes gjetjen e zgjidhjeve legjislative që do të shërbejnë për zbatimin e rekomandimeve të këtyre misionëve vezhgues të zgjedhjeve parlamentare që janë zhvilluar më 2021, 2025 dhe zgjedhjet për pushtetin vendor, 2023. Një përmbledhje e këtyre rekomandimeve të dhëna në Raportet përfundimtar të OSBE/ODIHR për zgjedhjet parlamentare që u zhvilluan në vitin 2021 dhe zgjedhjet lokale, që u zhvilluan në vitin 2023 si dhe reflektimet për zbatimin e tyre, jepen në Aneks 1. Mbështetur në Raportin paraprak për zgjedhjet parlamentare, 2025, në Aneks 2 është dhënë një listë me çështjet që priten të jenë pjesë e rekomandimeve të OSBE/ODIHR. Në Aneks 3 listohen çështjet kryesore që

trajtohen si objekt per Reformen zgjedhore ne Raportin e vevzhguesve vendor te angazhuar prej Qendres per Zhvillimin e Shoqerise Civile, ne njesine zgjedhore, qarku Durres.

Në raportet e publikuara nga misionet nderkombetare per vevzhgimin e zgjedhjeve qe jane zhvilluar ne periudhen 2021-2023, jane dhene 74 rekomandime të përgjithshme. Keto rekomandime trajtojnë çështje qe lidhen me:

- i. Depolitizimin e administratës zgjedhore,
- ii. Parandalimin e abuzimit me burimet publike,
- iii. Forcimin e hetimeve mbi shitblerjen e votës,
- iv. Votimin nga diaspora,
- v. Transparencën në media dhe financime.

Nder keto rekomandime, ne kuader te perгатitjes se zgjedhjeve te rrardhes jane trajtuar ne menyre ose plote ose te pjeseshme nga trupa legjislative dhe/ose nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve vetem rreth 30-35 perqind e tyre.

Duke patur parasysh Raportin Paraprak te Misionit te Vevzhguesve Nderkombetar te OSBE/ODIHR, objekt i rekomandimeve qe do te permbahen ne Raportin Perfundimtar te tyre per zgjedhjeve parlamentare, 2025 priten te jene çështjet qe lidhen me:

- i. Përdorimi i burimeve publike
- ii. Barazia mes kandidatëve
- iii. Intimidimi dhe presioni
- iv. Vota nga diaspora
- v. Financimi i fushatës dhe transparenca
- vi. Teknologjia në votim dhe numërim
- vii. Regjistrimi i votuesve dhe listat e votuesve
- viii. Polarizimi politik dhe besimi
- ix. Përmirësim i kapaciteteve të administratës zgjedhore
- x. Mediat dhe komunikimi publik

Referuar Raportit të vevzhguesve vendor qe angazhoi CSDC ne qarkun e Duresit per vevzhgimin e zgjedhjeve parlamentare, maj 2025, nder ceshtje qe duhet te jene objek trajtimi ne kuader te Refomes zgjedhore mund te listohen:

- i. Rritje e aftesive profesionale ne administraten zgjedhore, komisionet e nivelit te dyte dhe te trete.
- ii. Rritje e hapsirave per pjesemarrjen aktive te qytetarve ne hartimin e listes se zgjedhesve, nepemjet forcimit te detyrimit te pushtetit vendor per bashkeveprim me ta
- iii. Forcim i masave shtrenguese per mos perdorimin e asetave publike per fushaten zgjedhore
- iv. Rritjen e presionit te ligjit per te ndaluar intimidimin e zgjedhesve, ne vecanti diten e votimit dhe ne qendern e votimit

- v. Forcimin e aktit rregullator per parandalimine votimit familjar dhe keqperdorimit te votimit me prokure per zgjedhesit me aftesi ndryshem
- vi. Krijimi i kushteve per votim per zgjedhesite paraplegjik, tetraplegjike dhe te verbër.
- vii. Mundesi per votimin ne kuti te levizeshme per zgjedhesit qe per arsye shendetsore ose moshe nuk paraqiten dote ne qendren e votimit.

3. Mbi kompleksitetin e Reformes zgjedhore

Reforma zgjedhore është një proces legjislativ, në të cilin ndërthuren dhe bashkeveprojne faktorë të natyrave të ndryshme. Nder ta si me të rendesishem pranohet se janë faktoret që lidhen me:

- (i) interesit politik që kanë partitë politike, me synimin dhe angazhimin e tyre për të ndertuar rregulla që ju japin me shumë mundësi për sukses në garat zgjedhore,
- (ii) domosdoshmerine për ndertimin e një kuadri ligjor për zgjedhjet që të jete i përafuar me kërkesat dhe standardet që kanë legjislacion zgjedhor që zbatohet në vend të me demokraci të zhvilluar,
- (iii) paqyrimin në legjislacion të parimeve themelore të trashëgimise zgjedhore europiane dhe të kërkesave, standardeve dhe rekomandimeve që jepen në Kodin e Praktikave të Mira për Çështjet Zgjedhore, të Komisionit të Venecies,
- (iv) nevojën për ndertimin e rregullave, kërkesave dhe procedurave ligjore që respektojnë veçoritë, traditën dhe kulturën e shoqërisë shqiptare.

Kompleksiteti i këtij procesi dhe interesi i shtuar për produktin që realizohet nëpërmjet tij ka bërë që, në mënyrë të vazhdueshme ky proces të jete i përballuar me sfida, zgjidhja e të cilave, në jo pak raste, ka qenë e pamundur të arrihej pa asistencë teknike dhe keshillimin nga ekspertë ndërkombëtar të fushës. Kjo rrethane, prezente në pothuajse të gjitha reformat zgjedhore të kryera deri sot, kërkon që, në dokumentin e politikave në zbatim të të cilave do të kryhet Reforma zgjedhore nga Kuvendi i Shqipërisë i dalë prej zgjedhjeve që u zhvilluan në 11 maj, 2025, të përfshihet edhe:

Kërkesa e Kuvendit të Shqipërisë tek institucionet ndërkombëtare, në veçanti OSBE/ODIHR dhe Komisioni i Venecies për asistencë dhe keshillim teknik e profesional të Komisionit parlamentar *ad-hoc* për Reformën zgjedhore.

Analiza e rezultateve të marra nga zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë ose/edhe zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore, në veçanti në zgjedhjet e zhvilluara pas ndryshimeve kushtetuese të bëra në Prill, 2008 dhe pas Reformës në Pushtetin vendor dhe Reformës territoriale-administrative, tregojnë se për funksionim efektiv të demokracisë përfaqësuese në nivelin qendror dhe në pushtetin lokal është e nevojshme që, si objekt i reformës zgjedhore, krahas hartimit të rregullimeve ligjore për zbatimin e rekomandimeve të vëzhguesve ndërkombëtar dhe vendor, të jenë edhe çështje që lidhen me sistemin zgjedhor dhe mënyrat e zbatimit të tij për zgjedhjet parlamentare dhe për keshillat bashkiak. Trajtimi i këtyre çështjeve është një ndër sfidat kryesore

me te cilat perballat aktualisht procesi i rregullimeve te metejshme te legjislacionit ne fushen e zgjedhjeve ne Shqiperi.

Në dokumentin e politikave per Reformen zgjedhore është e nevojshme qe te listohen dhe te tregohen rruge per zgjidhjen e çështjeve qe lidhen me:

- (i) menyren dhe rregullat sipas te cilave duhet te realizohet nje proces zgjedhor, objektiv kryesor i te cilit duhet te jete zhvillimi i zgjedhjeve demokratike, qe respektojne dhe plotesojne standardet nderkombetare dhe
- (ii) domosdoshmerine per te realizuar produkte zgjedhore qe kane besimin e qytetarve dhe jane legjitime e perfaqesuese.

4. Nevoja për hartimin e dokumentit mbi “Politikat për zhvillimin e Reformës zgjedhore”

Kompleksiteti i Reformes zgjedhore dhe efektet e pasojat e rendesishme qe sjellin zgjidhjet legjislative qe realizon kjo reforme ne ushrimin efektiv te demokracise perfaqesuese, bejnë te domosdoshme qe, per kryerjen e saj të përcaktohet qartë:

- (i) tërësia e problemeve dhe çështjeve qe do te jene objekt i kesaj reforme,
- (ii) percaktimi i bashkelidhjeve midis çështjeve qe pranohen si objekt i Reformes zgjedhore me legjislacionit tjetër, veprimet e te cilin ndikojne ne ecurine e procesve zgjedhore dhe listimi i nderhyrjeve qe duhet te behen ne kete legjislacion,
- (iii) organizimi institucional, duke i dhene perparesi zhvillimit te Reformes zgjedhore si nje proces gjithepershires,
- (iv) shtrirja ne kohe e Reformes zgjedhore,
- (v) rruget qe do te perdoren per te siguruar asistencen teknike dhe profesionale te experteve nderkombetar.

Per te mundesuar zhvillimin e Reformes zgjedhore, ne perputhje me percaktimet e mesiperme është e nevojshme qe per kryerjen e saj te hartohet nje dokument ne te cilin te permbahen drejtimet kryesore te politikave sipas te cilave dhe ne plotesimit te objektivave te percaktuara ne to, do te kryhet kjo Reformë.

5. Mbi dokumentin e Politikave për Reformën zgjedhore

Hartimi i dokumentit te politikave per Refomen zgjedhore është një moment i rendesishem per zhvillim e sukseshem te kesaj Reforme. Ne kete dokument duhet qe te shprehet qarte objekti i kesaj Reforme, objektivat qe synohet te arrihen nepermjet saj, parimet ne baze te te cilave zhvillohet Reforma zgjedhore, çështjet legjislative qe do te jene objekt trajtimi, metodologjia e punes, koha dhe instrumentat qe mund te perdoren per te bere te mundur zhvillimin e saj si nje proces gjithepershiren ne problematiken legjislative dhe ne pjesemarrje.

Në dokumentin e politikave per reformen zgjedhore jepen shpjegime në lidhje me:

- i. Sistemin zgjedhor sipas te cilit behen zgjedhjet, Kodin zgjedhor dhe rolin e administrates zgjedhore, KQZ e komisioneve te niveleve te tjere, rolin e partive politike ne

administrimin e zgjedhjeve etj...

Në Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë përcaktohet që zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë behen në përputhje me kërkesat e sistemit proporcional rajonal. Kodi zgjedhor përcakton 12 rajonet e vendit si 13 njësitë zgjedhore, në të cilat subjektet politike garojnë me liste kandidatësh. 1/3 e kandidatëve të kësaj liste është e mbyllur dhe për kandidatet në vijim zgjedhësit votojnë edhe me votë parapëlqyese për kandidatin që dësherojnë.

Sistemi dhe mënyra e zbatimit të tij si dhe votimi me listë të hapura janë dy argumenta të rëndësishëm që duhet të trajtohen në Reformën zgjedhore.

Në Kodin zgjedhor përcaktohet se administrata zgjedhore, komisionet e të gjithë niveleve formohen në bazë të parimit të përfaqësimit dhe balancimit politik. Është rekomanduar që ndryshimi i këtij rregulli të jetë pjesë e Refomes zgjedhore.

- ii. Problemet dhe sfidat me të cilat janë përballur zgjedhjet e fundit, të zhvilluara në 2021, 2023 dhe 2025

Identifikimi i problemeve dhe sfidave me të cilat janë përballur proceset e fundit zgjedhore, në një pjesë të konsiderueshme të tyre behen pjesë e Reformës zgjedhore nëpërmjet trajtimit dhe gjetjes së zgjidhjeve dhe rregullimeve ligjore që duhet të behen, për të zbatuar rekomandimet e vëzhguesve ndërkombëtar dhe vendas.

- iii. Analiza e faktorëve që kanë ndikuar negativisht në zheliminimin e zgjedhjeve në përputhje dhe respektim me standardet për zgjedhje demokratike, me theks në efektet që kanë sjell polarizimi politik, abuzimi me burimet publike, mungesa e transparencës financiare, pasaktësitë në listat e votuesve etj

Çdo ndryshim që do të behet në legjislacionin zgjedhor është e nevojshme të paraprihet nga një analizë sa më e plotë e çështjes ose problemit që është objekt i tij. Identifikimi i faktorëve përgjegjës për fenomenin dhe vlerësimi i mënyrës së veprimit dhe bashkëveprimit të tyre është e rëndësishme për të gjetur zgjidhjet me efektive për ndryshimin ligjor që do të behet.

Referencat tek raportet e OSBE/ODIHR dhe tek raportet e publikuara nga organizatat e shoqërisë civile që kanë vrojtuar zgjedhjet janë burimi kryesor i informacionit për hartimin e politikave për reformën zgjedhore dhe për përcaktimin e rrugëve, instrumentave dhe draft-zgjidhjeve që do të propozohen për ndryshime në legjislacionin zgjedhor.

5.1 Vizioni, parimet dhe objektivat e politikave për Reformën zgjedhore

Përvojat e derisotme në reformat zgjedhore nënvizojnë faktin se proceset legjislative që janë kryer në kuadër të tyre, në të shumtën e rasteve kanë qenë të ndikuara dhe janë realizuar si procese në shërbim të interesave politike të dy partive kryesore të vendit. Është e vështirë që në këtë reformë të gësh produkte në të cilat të mos ndihet efekti i këtij interesi politik. Reformat janë trajtuar si mundësi bipartizane për të ndërtuar terrene legjislative për të mbështetur garën zgjedhore të PS dhe PD. Efektet e kësaj qasje ndaj Reformës zgjedhore kanë bërë që produktet e marra të mos kenë arritur pritshmeritë që duhet të kenë procese të tilla legjislative.

5.1.1 Vizioni i Reformes zgjedhore

Reforma zgjedhore e zhvilluar ne vitin 2020, ne baze te te ciles ishte dakortesia politike e arritur ne qershor, 2020 ne Keshillin Politik, me mbështetjen dhe presionin e faktorit nderkombetar, është nder te paktat reforma zgjedhore ku u be e mundur arritja e nje kompromisi politik qe ballancoi interesin politik me perpjekjet per te arritur ne ndertimin e nje legjislacioni zgjedhor qe, ne krahasim me te meparshmin krijuan kushte me te mira per zhvillimin e zgjedhjeve demokratike. Pervoja e arritur në Reforme zgjedhore, 2020, nenvizon vleren dhe rendesine e madhe qe ka zhvillimi i kesaj reforme sipas dhe ne zbatim te nje Politike te miredizenjuar, ne te cilen duhet te te percaktohet qarte, në menyre te plote dhe shtrruese Visioni i saj. Percaktimi i vizionit dhe dakortesia e angazhimi i paleve pjesemarrëse ne Reformen zgjedhore per respektimin e tij është nje nder momentet e rendesishem qe kushtezon suksesin dhe arritjen e pritshmerive per te gjithë Reformen. Nderkohe, duhet te theksohet se ne cdo rast Vizioni i Reformes zgjedhore duhet te jete i perputhur dhe te pasqyroje kerkesat dhe karakteristikat e stadin aktual te zhvillimin politik, ekonomik, social dhe demokratik te vendit dhe shoqerise.

Duke ju referuar zhvillimeve te derisotme ne proceset zgjedhore dhe pervojave te krijuara nga proceset legjislativ qe kane patur si objekt te tyre legjislacionin zgjedhor, Vizioni i Reformes zgjedhore qe pritet te filloje, mund te formulohet si ne vijim:

Hartimi i nje legjislacioni zgjedhor qe krijon kushte mbështetëse per zbatimin efektiv te sistemit zgjedhor dhe per zhvillimin e zgjedhjeve qe plotesojne parime baze te trashegimise zgjedhore europiane, angazhimet e OSBE, rekomandimet e Kodit te Praktikave te Mira ne Çështjet Zgjedhore te Komisionit te Venecisë, transparente, gjithëpërfshirëse dhe qe arrijne te sigurojnë besimin e plote te qytetareve ne proceset zgjedhore

5.1.2 Parimet udhëheqëse të Reformës zgjedhore

Duke ju referuar dokumentave nderkombetar dhe keshillave të dhena nga ekspertet nderkombetar qe kane ndihmuar per zhvillimin e reformave zgjedhore ne Shqiperi, percaktimi i parimeve qe duhet te respektohen dhe qe palet pjesemarrëse ne Reformen zgjedhore duhet te pranojne si parime udheheqese ne kete process legjislativ është moment shume i rendesishem qe duhet te trajtohet ne politikat per Reformen zgjedhore.

Analiza e raporteve te vezhguesve nderkombetar dhe vendor, per tre proceset e fundit zgjedhore qe jane zhvilluar ne Shqiperi dhe bashkengjitur me të edhe analiza e efekteve qe ka dhene zbatimi i legjislacioni aktual ne cilesine e perfaqesimit, integritetit dhe ne besimin e publikut tek produkti qe kane realizuar keto zgjedhjeve, si parime udheheqese per Reformen zgjedhore mund te percaktohen:

- i. Barazia në garën zgjedhore, fuqi e barabarte e votes, krijimi i kushteve mbështetese per përfaqësim proporcional.
- ii. Paanësi politike dhe depolitizim institucional
- iii. Llogaridhënie dhe transparencë financiare
- iv. Bashkrendim efektiv nderinstitucional dhe me shoqerine civile
- v. Pjesëmarrje e lire e qytetarve ne zgjedhje dhe krijim i kushteve per te mundesuar, ne

menyre me efektive, votimin nga jashte territorrit te vendit.

- vi. Përdorim i teknologjisë për transparencë dhe efikasitet ne zbatimin e legjislacionit zgjedhor

5.1.3 Objektivat strategjikë

Duke ju referuar Vizionit te kesaj reforme zgjedhore, çështjeve dhe problemeve qe duhet te jene objekt i saj, si objektivave mund te listohen:

1. Hartim i nje legjislacioni zgjedhor te perafuar me kerkesat dhe standardet e OSBE/ODIHR, zbatimi i te cilit te sjell zhvillimin e procesit zgjedhor dhe zgjedhjeve demokratike
2. Rritje e cilesise ne veprimin e demokracise perfaqesuese nepermjet krijimi te kushteve per gare te barabarte ne zgjedhje dhe per perfaqesim propocional objektiv në garë dhe në rezultat.
3. Rritje e efektit te votes parapelqyese te zgjedhesve ne zgjedhjen e deputeteve dhe antarëve te keshillave bashkiak.
4. Rritje e cilesive profesionale ne administrimin e zgjedhjeve dhe e besimit te zgjedhesve ne pavaresine partikae dhe në integritetin ne vendimmarrjet e komisioneve zgjedhore.
5. Garantimi i transparencës financiare dhe mbikëqyrjes së pavarur të fushatave zgjedhore.
6. Rritje e rolit te mediave ne fushate zgjedhore dhe parandalimi i keqepedorimit te saj, ne vecanti i medias sociale.
7. Rritje e efektivitetit ne bashkeveprimin institucional dhe me shoqerine civile per parandalimin dhe zvogelim e shfaqes se fenomeneve qe ndikojne negativisht ne standardet e zgjedhjeve.
8. Përmirësimi i rregullave per votim nga nga jashtë vendit dhe mundesi me efektive per votim per zgjedhesite me aftesi ndryshe dhe kufizime ne levizje
9. Parandalimi i keqpërdorimit të burimeve publike dhe shitblerjes së votës.
10. Përdorim me efektiv te te drejtes per ankimim.

5.2 Çështje dhe probleme, objekte trajtimi në Reformën Zgjedhore

5.2.1 Sistemi zgjedhor

Sfida

Per zbatimin e sistemit zgjedhor te percaktuar ne Kushtetute, Kodi zgjedhor percakton 12 njesi zgjedhore, koresponduese te 12 qarqeve te vendit.

Per zbatimin e dispozites kushtetuese qe parashikon votimin me vote parapelqyese Kodi zgjedhor percakton ndarjen e listes se kandidateve ne dy pjesë- 1/3 e liste e mbylluar dhe 2/3 e saj e hapur.

Keto rregulla per zbatimin e Sistemit zgjedhore kanë bërë që:

- (i) Fuqia e votes per te prodhuar mandat deputeti ndryshon ne vartesi te njesise zgjedhore
- (ii) Partite e reja dhe partite e vogla politike nuk fitojne mandate ne propocion me votat qe fitojne. Ndarja e vendit ne 12 njesi zgjedhore dhe formula per shperndarjen e mandateve favorizon dy partite e medha

(iii) Midis kandidatëve të të njëjtit subjekt krijohen diferenca esenciale në mënyrën se si shpërndahen mandatet që fiton subjekti.

Propozim për zgjidhje:

Pa ndryshuar dispoziten kushtetuese që percakton si sistem zgjedhor, Sistemin Proporcional Rajonal dhe as dispoziten që percakton se vota parapëlqyese mund të përdoret nga zgjedhësi për kandidatë që përbejnë jo më pak se 2/3 e numrit të përgjithshëm të kandidatëve në listën shumëmerore të subjektit përkatës, sfida e mësipërme mund të zgjidhet nëse në Kod vendosen dispozita, në të cilat të percaktohet:

- (i) Për efekt të zgjedhjeve parlamentare vendi të ndahet në katër njësi zgjedhore
- (ii) Në çdo njësi zgjedhore zgjedhësi të ketë të drejtë të votojë me votë parapëlqyese një nga të gjithë kandidatët e listës shumëmerore të subjektit përkatës. Për zgjedhjet për Keshillat bashkiak votimi të bëhet me listë plotësisht të hapura, zgjedhësi të votojë me votë parapëlqyese për një nga kandidatët e listës shumëmerore të subjektit që do.
- (iii) Mandatet që fiton subjekti zgjedhor të shpërndahen tek kandidatët e listës së tij për deputet ose për antarë të Keshillit bashkiak, pasi kandidatët të rirënditen në bazë të numrit të votave parapëlqyese që fitojnë.

Indikator suksesi

Fuqia e votës për t'u konvertuar në mandat deputeti çlirohet proporcionalisht në mënyrë të ndjeshme nga efekti negativ që ka sjell ndarja e vendit në 12 njësi zgjedhore. Partitë e reja dhe partitë e vogla politike kanë mundësi me të mëdha për t'u përfaqësuar në Kuvendin e Shqipërisë në mënyrë proporcionale me votat që ato fitojnë.

Ndarja diskriminuese midis kandidatëve, në listë të fiksuara dhe në listë të hapura, do të sjellë rritjen e angazhimit të subjekteve politike për të hartuar listë me kandidatë me cilësori dhe më shumë të barabartë për vlerat që zotrojnë. Cilësia e Kuvendit dhe/ose e Keshillit bashkiak rritet

5.2.2 Depolitizimi i administratës zgjedhore

Sfidë

Zgjedhje e antareve të KQZ pas përzgjedhjes nga partitë politike të kandidatëve për antare nga lista e personave që shprehin interesin.

Emërime të motivuara politikisht në nivelet lokale dhe qendrore të administratës zgjedhore, në bazë të parimit të përfaqësimit dhe ballancimit politik

Ndryshime të papritura dhe pa nevojë për motivim anëtarësh/sekretarësh nga partitë politike, ndryshime që ndikojnë në vazhdimësinë dhe besueshmërinë në administrimin e procesit zgjedhor

Propozim për zgjidhje

- (i) Ndertimi i KQZ sipas një institucioni plotësisht monokratik.
- (ii) Fillim i procesit të departizimit të komisioneve të nivelit të dytë dhe të tretë. Miratim i procedurave dhe standardeve për kualifikimin dhe procesin e përzgjedhjes të anëtarëve të këtyre komisioneve dhe shpërndarjen e tyre në komisionet zgjedhore.

(iii) Mandati i anëtarëve të komisioneve të mos ndërpritet gjatë procesit zgjedhor, përveç rasteve të shkeljes së rëndë profesionale.

(iv) KQZ të ketë të drejtën të caktojë zëvendësime vetëm mbi bazë të procedurave të qarta dhe transparente.

(v) Ngritja e nje Qendre Trajnimi e Kualifikimi ne Vazhdim, si strukture e vecante, per trajnimin dhe certifikimin e antareve te komisioneve zgjedhore, numerueseve dhe vëzhguesve qe aktivizojne shoqatat e shoqerise civile.

(vi) Krijimi i një databaze publike dhe transparente, Regjistër Kombëtar i Administratorëve Zgjedhorë, me informacion per personat e trajnuar, kualifikuar dhe certifikuar per te kryer detyren e administratorit te procesit zgjedhor.

Indikator suksesi

-Ulje e ankesave lidhur me emërimet dhe per administrimin e procesit zgjedhor.

-Rritje e pjesëmarrjes së personelit të trajnuar dhe rritje e kapaciteteve profesionale te administrates zgjedhore;

-Rritje e nivelit te paanshmërise ne vendimmarreje dhe qëndrueshmëri institucionale në organizimin e zgjedhjeve.

-Rritje e besimit qytetar ne zgjedhjet dhe vlerësim pozitiv në raportet e vëzhguesve nderkombetar dhe vendas.

5.2.3 Financimi i fushatave zgjedhore dhe transparenca

Sfidë

Raportim jo i plotë dhe real i fondeve private nga partite politike dhe kandidatet; mungesë informacioni per gjurmueshmërie për fondet që vijnë nga palë të treta, kapacitete te pamjaftueshme per monitorimin ne kohe reale te donacioneve private

Propozim për zgjidhje

(i) Ngritja e nje Sistemi raportimi ne kohe reale i të ardhurave dhe shpenzimeve, i lidhur me organet e tatim -taksave dhe bankat e nivelit te dyte për verifikim automatik te burimit dhe menyres se perdorimit te fondeve jo publike qe partite perdorin per qellime te fushtes zgjedhore

(ii) Detyrim ligjor per partite politike dhe kandidatet e tyre, i shoqeruar me sanksione efektive, per rritjen e transparences nepermjet raportimit, ne kohe reale, në një sistem publik elektronik të administruar nga KQZ, te çdo donacioni dhe shpenzimi qe kryhet ne fushaten zgjedhore. Shtrirja e ketij detyrimi per te gjithë periudhen e zgjedhjeve, qe fillon me dekretimin e dates se zgjedhjeve nga Presidenti i Republikes dhe perfundon me shpallajen e rezultatin final te zgjedhjeve prej KQZ.

(iii) Ndalim i përdorimi i fondeve “cash” gjatë fushatës; të gjitha transaksionet të kalojnë përmes bankave.

(iv) Parashikimi ligjor per kufijë të qartë dhe ndalime për donacione anonime

(v) Rritje e kapaciteteve te KQZ per monitorimin ne kohe reale dhe kontrollin financiar të partive pas zgjedhjeve, nepermjet ngritjes, si pjese e organigrames strukture te saj, të nje

strukture te dedikuar per ndjekjen dhe kontrollin e financimit te partive politike dhe, ne vecanti per financimin e fushates zgjedhore te tyre.

(vi) Forcim i sanksioneve dhe parashikim i humbjes se te drejtes per financim publik dhe/ose humbje e te drejtes per te marr pjese ne zgjedhje per partite qe raportojnë saktë ose fshehin burime të financimit.

(vii) Për shkelje të rënda (financim të paligjshëm), kandidatët të përjashtohen nga gara zgjedhore

Indikator suksesi

- Raportime në kohë dhe auditime të përfunduara sipas parashikimeve ligjore
- Rritje e transparences per burimet financiare private.
- Rritje e numrit te denoncime nga organizata te shoqerise civile

5.2.4 Shitblerja e votës dhe përdorimi i burimeve shtetërore

Sfidë

Raporte të përsëritura për shitblerje vote, presion mbi punonjës publikë dhe përdorim i aseteve publike në fushatë

Propozim për zgjidhje

(i) Forcim i mekanizmave ligjor per identifikimin fenomenit te shitbleres se votes dhe perdorimit te aseteve publike per fushen zgjedhore.

(ii) Formimi i një task-force të përbashkët (SPAK/KP/Prokurori Publik/Polici) të specializuar për krimet zgjedhore dhe koordinim me KQZ për evidentimin administrativ.

(iii) Percaktim i qarte dhe pa ekuivok i shkeljeve qe lidhen me perdorimin e aseteve publike dhe veprimtarive qe publike qe nuk lejohen gjate procesit zgjedhor qe fillon me shpalljen e dekretit te Presidentit per daten e zgjedhjeve

(iv) Rritje dhe forcim i sanksioneve dhe zbatimi i tyre: gjoba, përjashtim nga gara për partitë/kandidatët që provohen të kenë përdorur në mënyrë sistematike burime publike në fushatë.

(v) Transparencë financiare në kohë reale: sistem online i raportimit të shpenzimeve të fushatës me verifikim automatik dhe auditime të detajuara pas fushatës.

(vi) Fushata ndërgjegjësuere për qytetarët mbi pasojat e shitblerjes dhe kanalet për raportim anonim.

(vii) Përdorim i teknologjise se informacionit per te rritur kapacitete per pjesemarrje te qytetarve ne denoncimin e shkeljeve dhe krimeve zgjedhore.

Indikator suksesi

- Numër më i lartë i hetimeve efektive dhe ndjekjeve penale,
- Ulja e rasteve të raportuara të shit-blerjes se votes,
- Rritje e denoncimeve per perdorim te aseteve publike per fuashten zgjedhore,
- Rritje e pranime dhe marrja e vendimeve per denim te denoncimeve .

5.2.5 Votim i fshehtë dhe parandalimi i intimidimit te zgjedhesve

Sfidë

Mos ruajtja e fshehtesise se votes, si pasoje e votimit familjare, votimit me prokure, intimidimit te zgjedhjes perpara votimit ne qendren e votimit.

Propozim për zgjidhje

(i) Rishikim i udhezimeve per procedurave ne qendren e votimit ditën e zgjedhjeve, per te parandaluar veprimin e faktoreve qe ndikojne negativisht ne fshehtesinë e votes.

(ii) Mbështetje per monitorimin me intensiv dhe më efektiv nga vëzhgues të pavarur te procesit te e votimit

(iii) Rritje e kapaciteteve per komunikim dhe denoncim te ngjarjeve, rasteve dhe personave qe me veprimet ose mosveprimet e tyre ndikojne negativisht ne fshehtesine e votes

(iv) Forcim i sanksioneve ndaj shkeleseve te fshehtesise se votes

Indikator suksesi

-Zvogelim i raportimeve per rastet e shkeljes se fshehtesise se votes

5.2.6 Regjistrimi i votuesve dhe votimi nga jashte territorit te vendit

Sfidë

Mos plotesim nga pushtetit vendor i detyrimeve ligjore per realizimin e nje procesi efektiv per hartimin e listes se zgjedhesve, procedura të paqarta dhe afate të madha/kontradiktore për regjistrimin e votuesve jashtë vendit; rrezik outsourcing/keqpërdorim në logjistikë.

Propozim për zgjidhje

(i) Perditesim çdo vit, ne afatet e parashikuara ne ligj i listave te zgjedhesve nepermjet bashkepunimit ndërinstytucionale midis MPB-së, Drejtorisë së Gjendjes Civile dhe KQZ-së.

(ii) Krijim i një mekanizëm efektiv ankimi për korrigjimin e të dhënave personale deri 30 ditë para ditës së votimit.

(iii) Hartim i një procedurë e veçantë ligjore për regjistrimin dhe votimin e qytetarëve që jetojnë jashtë Shqipërisë.

(iv) Parashikim i detyrimit ligjor per ndertimin e një platforme elektronike të sigurt, per rregjistrimin e zgjedhesve qe votojne nga jashte vendit.

(v) Rrshikim i menyres se votimit nga jashte vendit duke vlersuar edhe mundesite per votim nepoermjet internetit.

(vi) Publikim online, ne menyre periodike dhe te aksesueshme te leistes se zgjedheseve, duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale.

(vii) Detyrim ligjor per KQZ per te bere pilotime periodike per procesin e votimit nga jashte vendit

Indikator suksesi

-Zvogelim i rasteve te pamundesises per te votuar si pasoje e pasaktesive ne listene zgjedhesve

-Rritje e numrit të votave të vlefshme të ardhura nga jashtë vendit
-Zvogelim i vonesave ose i humbjeve të votave që vijnë nga jashtë vendit
-Rritje e transparencës në procesin e hartimit të listës së zgjedhësve që votojnë brenda ose jashtë vendit.

5.2.7 Media në fushatën zgjedhore

Sfida

Media audiovizive dhe mediat sociale në kaperxim të ligjit trajtohen nga partitë /kandidatë si instrumenta dhe rrugë që ju krijojnë mundësi të shtuara mbështetese në garën zgjedhore

Propozim për zgjidhje

Ndryshimet në Kodin zgjedhësor synojnë:

- (i) Rregullim të përdorimit të reklamave politike;
- (ii) Garanci për qasje të barabartë në media për subjekte zgjedhore, kandidatë dhe , në vecanti për kandidatët gra/vajza.
- (iii) Transparencë për pronësisë mediatike;
- (iv) Kontroll dhe raportim mbi shpërndarjen mediave gjatë fushatave
- (v) Mbulimi i drejtë dhe transparenca në kontratat për reklamat politike
- (vi) Nderim të mekanizmave që do të mundësojnë rritjen e efektivitetit dhe efektit të monitorimit të mediave nga AMA e KQZ
- (vii) Kontroll të mediave sociale dhe rregullim me efekt ligjor për sjelljen e tyre në fushatat zgjedhore.
- (viii) Forcimi të sanksioneve

Indikator suksesi

-Zvogelim i rasteve që identifikohen dhe denoncohen si keqpërdorim i mediave në fushatën zgjedhore

5.2.8 Ankimet zgjedhore, administrimi dhe gjykimi

Sfida

Në jo pak raste hetimi administrativ dhe penal i ankimeve zgjedhore, si pasoje e ndikimit politik, nuk arrijnë të plotësojnë pritshmëritë.

Propozim për zgjidhje

- (i) Qartësimi i juridiksionit dhe kompetencave institucionale
- (ii) Përcaktimi i afatit procedural më të qarta dhe të arsyeshme
- (iii) Hartimi i standardeve për provat dhe transparencën në shqyrtim
- (iv) Rishikimi i mekanizmit të ankimit gjyqësor
- (v) Ndërtimi i një sistemi dixhital për menaxhimin e ankimeve
- (vi) Forcimi i kapaciteteve profesionale dhe pavarësisë së KAS-it
- (vii) Koordinimi institucional dhe komunikimi publik

Indikator suksesi

- Zvogelim i mbivendosjeve te kompetencave dhe shpejtim i procesit të shqyrtimit.
- Proces më i drejtë, dhe zvogelim i ndjeshëm i numrit te kontestimeve per vendimet qe merren.
- Rritje e transparence dhe reduktim i tensioneve paszgjedhore.

5.3 Përdorimi i teknologjise ne zgjedhje dhe transparenca

Përdorimi i teknologjise ne zgjedhje është një trend qe perhere e me shume është duke fituar terren. Përdorimi i saj, ne rradhe te parë kerkon qe gareuesit dhe zgjedhesite te kene besim dhe te vlersojne perparasite e saj dhe , ne asnje rast te mos e konsiderojne përdorimin e teknologjise si rruge per te krijuar besimin ne procesin zgjedhor.

Qëllimi

Të kryhen ne menyre me efektive , tew sigurte dhe më shume transparente procedurat që parashikohen diten e votimit , proceduar per vleresimin, numerimin evotave dhe tabelimin e rezultatit

Probleme që duhet të bashkëshoqërojnë përdorimin e teknologjisë së informacionit

Në legjislacion duhet te parashikohet

- (i) Auditim i pavarur - Çdo sistem teknologjik (votim elektronik, numërim elektronik, raportim online) të duhet te auditohet nga një organ i pavarur ndërkombëtar përpara përdorimit.
- (ii) Transparencë e kontratave - Të publikohen kontratat dhe specifikimet teknike të teknologjisë zgjedhore në faqen e KQZ-së. Pjesë e kontratës të jetë detyrimi për transparencë dhe akses publik në procesin e testimit.
- (iii) Fushatë informimi publik - KQZ tduhet ë zhvillojë fushata edukimi për qytetarët mbi mënyrën e përdorimit të teknologjisë në votim, për të shmangur konfuzionin dhe mosbesimin

5.4 Zhvillimi dhe monitorimi i reformës zgjedhore

Per te realizuar objektivat dhe pritshmëritë e Reformes zgjedhore është e nevojshme qe per zhvillimin dhe vleresimin e arritjeve te saj të:

- (i) Hartohet nje Plan i detajuar me afate kohore brenda te cilave parashikohet te realizohen ndryshimet e kerkuara ne legjislacion
- (ii) Të monitorohet niveli dhe cilesia e realizimit te ndyshimeve te propozuara ne legjislacion nga nje *Këshill Kombëtar per Monitorimi i Reformës Zgjedhore*, me përfaqësues të partive, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.
- (iii) Të sigurohet ndihmë teknike nga BE, OSBE, UNDP për komponentët e digjitalizimit, auditimit dhe transparencës financiare.
- (iv) Të hartohet Strategjia e advokimit per Reformen zgjedhore, ne te cilen te trajtohen si çështje kryesore:

-Institucionalizimi i nje Koalicion të gjerë, ne te cilin te perfshihen partitë politike palrlamantare dhe jo paralamentare, organizata të shoqërisë civile, eksperte akademik nga universitetit e vendit, perfaqesues te komunitetit ndërkombëtar (ODIHR, Venecia, BE).

-Analiza dhe pergatitja e materialeve studimore me te dhena nga raportet OSBE/

ODIHR dhe organizatat vendore, per Kuvendin dhe publikun.

-Zhvillimi i Fushatës publike dhe mediatike me materiale edukative, infografikë, debate publike, radio/TV dhe rrjete sociale për të shpjeguar nevojën dhe vlerat që ka zhvillimi i reformes zgjedhore.

-Lobim tek donatorëve ndërkombëtarë për të siguruar mbështetje teknike dhe financiare nga Bashkimi Evropian, OSBE, GTZ, etj., për komponentët teknologjikë dhe trajnimin.

-Hartim i programeve për trajnim të zyrtarëve të administratës zgjedhore, prokurorë, zyrtarë lokalë dhe media mbi legjislacionin zgjedhor dhe ndryshimet e bera.

5.5 Hartimi i Planit të Veprimit për Reformën zgjedhore

Për zhvillimin e Reformës zgjedhore duhet që Komision parlamentar ad-hoc të hartojë Planin e Veprimit, të ndarë në faza:

Faza 1 — Konsultim dhe hartim i dokumentit me draft ndryshimet që mund t'i propozohet Kuvendit (0–6 muaj).

Plani i Veprimit për këto faze duhet të parashikojë:

- Krijim i grupit të punës (KQZ + shoqëri civile + ekspertë Komisioni i Venecies/ODIHR).

- Hartim i paketës së ndryshimeve ligjore dhe aktet nënligjore të nevojshme.

- Konsultime publike dhe publikim i versionit para miratimit.

Faza 2 — Miratim i projekt ndryshimeve të propozuara (6–12 muaj)

- Miratim i Kodit zgjedhore të ndryshuar në Kuvend

- Miratim i planit 2-vjeçar të zbatimit; sigurim fondesh.

Faza 3 -Pilotim të procedurave përpara dekretimit të datës së zgjedhjeve (12–24 muaj)

-Pilotime të teknologjisë (regjistrimi i diasporës, teknologjia për votim, raportimi financiar në kohë reale).

-Trajnime dhe ristrukturim i procedurave.

Faza 4 - Monitorim, vlerësim dhe përmirësim në vijim (pas zgjedhjeve të rradhes)

5.6 Burime dhe materiale për konsultim dhe referencë

(i) ODIHR Final Report — Parliamentary Elections 2021.

<https://www.osce.org/files/f/documents/4/c/495052.pdf>

(ii) ODIHR Final Report — Local Elections 2023.

<https://www.osce.org/files/f/documents/0/a/557277.pdf>

(iii) ODIHR Interim / Needs Assessment & Interim reports for 2025 elections.

<https://www.osce.org/sq/odihr/elections/albania/590685>

(iv) Venice Commission — Draft amendments & Code of Good Practice.

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF\(2025\)029](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-REF(2025)029)

(v) ODIHR Handbook on Follow-up of Electoral Recommendations (për metodologji zbatimi). <https://www.osce.org/files/f/documents/c/8/244941.pdf>

Aneks I

Tabelë krahasuese e rekomandimeve të OSBE/ODIHR

Fusha / Çështja kryesore	Rekomandimet nga Zgjedhjet Parlamentare 2021	Rekomandimet nga Zgjedhjet Lokale 2023	Statusi i zbatimit (deri 2025)
Reforma zgjedhore	Të bëhet rishikim gjithëpërfshirës i Kodit Zgjedhor në konsultim me të gjitha palët.	Të vijojë reforma gjithëpërfshirëse duke përfshirë të gjitha rekomandimet e ODIHR.	Proces në zhvillim – KQZ ka propozuar ndryshime teknike (2024–2025), por reforma e plotë politike ende s’është përfunduar.
Depolitizimi i administratës zgjedhore	Të depolitizohet struktura e komisioneve zgjedhore (KZAZ, KQV).	Të shmangen emërimet partiake dhe rotacionet e panevojshme të anëtarëve.	Pjesërisht i zbatuar – KQZ ka përmirësuar trajnimin dhe kriteret, por sistemi mbetet politik.
Shitblerja e votës / presioni mbi zgjedhësit	Të hetohen dhe ndiqen penalisht rastet e shitblerjes së votës.	Të zbatohen masa parandaluese dhe hetime të pavarura.	Zbatim i pjesshëm – rastet hetuar, por pak dënime; OSBE e konsideron “problem të përsëritur”.
Sekretësia e votës	Të sigurohet fshehtësia e plotë e votës dhe ndalimi i presionit ndaj votuesve.	Të parandalohet votimi i grupit dhe intimidimi.	Përmirësim teknik, por ende shqetësim në disa zona; kërkohet më shumë mbikëqyrje.
Përdorimi i burimeve shtetërore	Të ndalohet përdorimi i aseteve publike në fushatë.	Të përcaktohen qartë kufijtë e përdorimit të resurseve publike.	Pjesërisht i zbatuar – ligji ekziston, por zbatimi praktik mbetet i dobët.
Mbrojtja e të dhënave personale	Të rritet mbrojtja e të dhënave zgjedhore pas skandalit të 2021.	Të garantohet mbrojtja e listave të zgjedhësve dhe përdorimi i tyre vetëm për qëllime zgjedhore.	Përmirësim i pjesshëm – u miratuan udhëzime nga KQZ, por mbikëqyrja mbetet e kufizuar.
Roli i mediave	Të rritet pavarësia e mediave dhe qasja e barabartë në transmetim.	Të garantohet mbulimi i drejtë dhe transparencë e kontratave të reklamave.	Pjesërisht i zbatuar – monitorim i KQZ për barazinë në fushatë, por ndikimi politik në media vazhdon.
Financimi i fushatave	Të rritet transparencë në raportimin financiar të partive.	Të përforcohen mekanizmat e auditimit të KQZ.	Përmirësim modest – raportim më i rregullt, por kontrollet ende jo të plota.
Pjesëmarrja e grave dhe grupeve vulnerabël	Të zbatohen kuotat gjinore në mënyrë efektive.	Të garantohet përfaqësimi gjinor dhe akses për personat me aftësi të kufizuara.	Pjesërisht i zbatuar – kuotat u respektuan në lista, por jo gjithmonë në drejtimin lokal.
Votimi elektronik dhe transparencë	Të sigurohet auditim i pavarur i sistemeve të votimit elektronik.	Të informohet publiku dhe të rritet transparencë mbi përdorimin e teknologjisë.	Zbatim i pjesshëm – pilotime të suksesshme, por mungon legjislacion gjithëpërfshirës.
Pjesëmarrja e diasporës	Të mundësohet votimi nga jashtë.	Të përgatitet infrastrukturë për votuesit jashtë vendit.	Ende i pazbatuar – KQZ ka bërë propozime, por mungon bazë ligjore.
Hetimet dhe sanksionet zgjedhore	Të forcohet mekanizmi i hetimit administrativ dhe penal.	Të sigurohet ndjekja penale e shkeljeve.	Zbatim i pjesshëm – KAS dhe SPAK kanë hetuar raste, por rezultatet ende të kufizuara.

Aneks II

Rekomandime të mundshme nga OSBE/ODIHR (paraprakisht)

Çështja	Rekomandim i mundshëm
Përdorimi i burimeve publike	Forcimi i rregullave dhe mekanizmave të mbikëqyrjes për të parandaluar që institucionet publike, asetet dhe programet sociale të përdoren për fushatë politike. Sigurim që të ketë sanksione bindëse për shkelësit.
Barazia mes kandidatëve	Rishikim i rregullave që garanton që të gjithë kandidatët dhe partitë të kenë akses të barabartë në burime, media, dhe mundësi komunikimi me votuesit. Kufizim i rasteve kur partia në pushtet ka avantazh të pakohë ose institucional.
Intimidimi dhe presioni	Masat ligjore dhe administrative që sigurojnë mbrojtje për votuesit dhe punonjësit publikë nga presioni, intimidimi ose keqpërdorimi i pozitës. Trajnim, monitorim dhe mundësi raportimi të pavarur.
Vota nga diaspora	Përmirësim i logjistikës dhe procedurave për votuesit jashtë vendit për të garantuar që vota të arrijë, të numërohet dhe të përfshihet me transparencë. Sigurim i afateve adekuate për paraqitje, për dërgimin e fletëve, dhe për analizë të mundësive të keqpërdorimeve.
Financimi i fushatës dhe transparenca	Legjislacion që detyron partitë dhe kandidatët të publikojnë burimet dhe mënyrat e financimit (donacione, huamarrje, reklama online, palët e treta). Autoritetet të kenë fuqi të mbikëqyrjes dhe gjobitjeve/sanksioneve.
Teknologjia në votim dhe numërim	Rishikim i përdorimit të teknologjive si votimi elektronik / numërimi elektronik: zgjerimi i përdorimit me masa sigurie të forta, sigurim të auditimit të rezultatit, transparencë më e madhe për procesin për publikun.
Regjistrimi i votuesve dhe listat e votuesve	Përmirësim i procesit të pasqyrim, trajtimi i problemeve si emrat e personave të ndjerë, përditësimi i listave, informim i votuesve për statusin e tyre. Një sistem tërësisht transparent për regjistrim.
Polarizimi politik dhe besimi	Iniciativa për dialog politik ndërmjet aktorëve politikë për të ulur polarizimin; përpjekje të institucioneve për të treguar transparencë dhe paanësi; informim publik për procesin dhe rolin e institucioneve zgjedhore për të rritur besimin.
Përmirësim i kapaciteteve të administratës zgjedhore	Trajnime të zgjedhura për anëtarët e komisioneve zgjedhore; përmirësim në menaxhimin e qendrave të votimit; sigurim që resurset njerëzore dhe financiare të jenë të mjaftueshme për zbatimin korrekt të procedurave.
Mediat dhe komunikimi publik	Rregullim i përdorimit të reklamave politike; garanci për qasje të barabartë në media; transparencë e pronësisë mediatike; kontroll dhe raportim mbi shpërndarjen mediave gjatë fushatave.

Aneks III
Çështje që rekomandohet për trajtim në Reformën zgjedhore
Raporti i CSDS
Zgjedhjet parlamentare, 11 Maj 2025 -Qarku Durrës

Ndalim i përdorimit të asetëve publike dhe administratës publike lokale për nevojat e fushatës zgjedhore

Transparenca e fondeve jo publike.

Forcimi i legjislacionit për të parandaluar dhe/ose dënuar rastet e mbështetjes nga oligarkët dhe/ose grupet kriminale të subjekteve zgjedhore/kandidate.

Balancim në pasqyrimin e fushatës zgjedhore nga mediat lokale dhe rritje e hapsirave për kandidatet gra/vajza.

Fillimi i departizimit të administratës zgjedhore.

Heqja e të drejtës që kanë partitë politike për zvendesimin, në çdo kohë dhe pa dhënë asnjë arsye, të antereve në komisionet zgjedhore

Rritje e saksionit për pushtetin lokal i cili nuk zbaton kërkesën ligjore për informimin, detyrë me detyrë, të zgjedhësve për qendren e votimit dhe për numrin e tyre në listën e zgjedhësve.

Vendosje e sanksioneve për mos plotësimin nga KZAZ, në bashkëpunim me pushtetin vendor, të kushteve lehtësues në qendren e votimit për votimin e personave me aftësi ndryshe.

Ndalim i votimit me prokur në rastet kur nuk respektohen përcaktimet ligjore

Ndalim i votimit familjar

Forcimi i rregullave dhe kushteve që parandalojnë prezencën në qendren e votimit të personave të paautorizuar

Parandalim dhe/ose dënim i rasteve të intimidimit të zgjedhësve dhe të shit-blerjes së votës.